

Pozita	Hartues i Testeve
Nr. i referencës	IKAF-03
Lloji i Kontratës	Kontratë shërbimi
Raporton	KMT
Departamenti/Komisioni	KMT
Forma e angazhimit	Honorar
Nr. i pozitive	5
Vendi:	Prishtinë

Instituti KAF është i përkushtuar në ndërtimin e profesionit të kontabilistëve dhe auditorëve në bazë të parimeve të larta Profesionale Etike, Standardeve Ndërkombëtare, sipas Rregulloreve të Ligjit në fuqi dhe sipas plan-programit të harmonizuar me ACCA dhe IIA Global.

Hartuesi i Testeve do të jetë i angazhuar në përpilimin e testeve, duke shfrytëzuar format e shkruara dhe standarde për përdorim në Institut. Pas formulimit të testeve, hartuesit do jenë të obliguar që të bëjnë rishikimin e tyre me qëllim që të vlerësohet nëse testi përmban paqartësi, supozime të papërcaktuara, ose të dhëna jo të plota. Pjesë e këtij procesi është edhe caktimi i poenave për pyetjet në bazë të ndërlikueshmërisë (kompleksitetit) dhe kohëzgjatjes që kërkohet për t'iu përgjigjur pyetjes, si dhe në bazë të rëndësisë relative të temës në programin studimor.

Kushtet e nevojshme:

Për titullin Hartues, kandidati duhet të dëshmojë dokumentacionin si më poshtë:

1. Dëshmon kualifikimin akademik dhe profesional
2. Dëshmon nivel të lartë dhe kompetencë profesionale që dëshmohet me:
 - a) Një numër të rëndësishëm të punimeve dhe aktiviteteve profesionale;
 - b) Pjesëmarrje aktive në seminare, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - c) Të ketë eksperiencë apo shkathtësi në hartimin e testeve;
 - d) Përvojë afatgjatë në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme;
 - e) Aftësi të lartë arsimore dhe pedagogjike përmes praktikës së arsyeshme;
 - f) Aftësi për udhëheqje akademike/profesionale;
 - g) Njohuri të theksuar të SNK/SNRF/SNA ose Standardet Profesionale të Auditimit të Brendshëm.